



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 42/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, dhe përmbaruesit privat, z. _____ dhe pas seancës këshillimore, me datën 17.11.2021, mori si në vijim:

V E N D I M

REFUZOHEN raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-42/2021, datë 06.10.2021, si dhe ankesa pala ankuese _____, përmes përfaqësuesit të saj z. _____, dt 06.10.2021, si të pabazuara.

A R S Y E T I M

Me datën 22.09.2021, përkatësisht, me datën 06.10.2021, pala ankuese NewCo Minex LLC SH.P.K, përmes përfaqësuesit të saj z. _____, drejtor, ka paraqitur një ankesën e plotësuar në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat z. _____. Pala ankuese thekson që përmbaruesi privat z. _____ ka vepruar në kundërshtim me nenin 367 par 1.1, 1.2, 1.7 dhe 1.10, të LPP-së pasi gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në kuadër të autorizimeve të tij ligjore lidhur me lëndën përmbarimore P. nr 970/2018, i njëjti nuk i është përmbajtur ligjit. Shton se përkundër që përfaqësuesi i palës kreditore “_____” përmes postës elektronike ka kërkuar nga përmbaruesi privat z. _____ ndërprejen e procedurës përmbarimore

për shkak të arritjes së marrëveshjes me debitorin, përkatësisht palën ankuese, i njëjti me dt 31.08.2021, i ka bllokuar palës ankuese llogaritë duke mos respektuar vullnetin e kreditorit. Pala ankuese thekson se përmbaruesi privat z. _____ ishte njoftuar se shpenzimet e procedurës përmbarimore deri në ndërprerjen e procedurës përmbarimore do të paguheshin nga kreditori. Sipas palës ankuese, tarifa e efikasitetit nuk i takon përmbaruesit privat dhe nuk duhet të zbatohet. Pala ankuese pretendon se nga përmbaruesi privat është ngarkuar në shumën prej 990.16 Euro për vlerën totale të borxhit duke përfshirë edhe borxhin fillestar të pretenduar nga ana e kreditorëve.

Me datën 06.10.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit private z. _____, si organ përmbarues i emëruar nga përmbaruesi i Territorin e Gjykatës Themelore në _____, lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën P. nr 970/2018.

Përmbaruesi privat z. _____ në përgjigjen e tij me shkrim thekson që procedura përmbarimore është iniciuar nga pala kreditore dhe pala debitore ka pranuar shkresat e lëndës. Pala debitore ka ushtruar prapësim ndaj urdhrin përmbarimor kurse pala kreditore përgjigje në prapësim. Me dt 03.10.2018, lënda është dërguar në Gjykatën Themelore në _____ dhe e njëjta me dt 04.12.2019 ka refuzuar prapësimin e palës debitore si të pabazuar. Pala debitore ka ushtruar ankesë ndaj atij vendimi kurse pala kreditore përgjigje në ankesë. Përmbaruesi privat thekson që meqenëse pala debitore nuk ka paguar garancionin e kërkuar nga Gjykata Themelore në _____, me dt 31.08.2021, lënda i është kthyer. Sipas përmbaruesit privat, derisa lënda ishte në Gjykatë, asnjëra nga palët, nuk e kishte njoftuar atë se ishte përmbushur borxhi lëndor i debitorit ndaj palës kreditore. Pas pranimit të shkresave të lëndës, me dt 31.08.2021, përmbaruesi privat thekson se ka bllokuar llogaritë bankare të palës debitore për borxhin lëndor, shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe shpenzimet e përfaqësimit, konform Aktvendimit të Gjykatës Themelore të Ferizajit PPP. Nr 112/18 dt 04.12.2019, me të cilin është refuzuar prapësimi i palës debitore ndaj urdhrin përmbarimor. Për sa i përket ndërprerjes së procedurës përmbarimore, përmbaruesi privat thekson se posa ka pranuar informatën, ai kishte kërkuar nga ana e kreditorit t'ia përcjell marrëveshjen e arritur me debitorin si dhe e kishte njoftuar për të gjitha procedurat që duhet ndjekur në mënyrë që të tërhiqet lënda nga Gjykata dhe e njëjta të përfundojë, kërkesa këto të cilat pala kreditore asnjëherë nuk i ka përfillur. Shton se me dt 31.08.2021 pala kreditore kishte njoftuar se borxhi është përmbushur në tërësi por përsëri nuk i janë përcjellë dëshmitë e kryerjes së borxhit lëndor. Me dt 01.09.2021, ka pranuar dëshmitë se është përmbushur borxhi lëndor si dhe marrëveshjen. Palët janë pajtuar t'i ndajnë shpenzimet e procedurës përmbarimore ashtu që pala debitore t'i mbulojë shpenzimet e procedurës përmbarimore kurse pala kreditore shpenzimet e përfaqësimit. Thekson se i ka njoftuar që në mënyrë që lënda të përmbillet duhet të kryhen të gjitha pagesat në tërësi. Pasi pala debitore ka kryer pagesat, menjëherë janë liruar llogaritë e palës debitore. Sipas përmbaruesit privat, shuma e shpenzimeve të procedurës përmbarimore dhe efikasitetit të përmbarimit nuk caktohet nga përmbaruesi privat por kjo rregullohet me Udhëzimin Administrativ MD-nr 06/2014 dt 27.03.2014 për Tarifat për Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbaruesit Privat. Përmbaruesi privat thekson që pas përfundimit të lëndës, palës debitore i ka dërguar urdhrin e Përfundimit të Procedurës Përmbarimore dhe pasqyrën e shpenzimeve.

Me datën 17.11.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, dhe përmbarruesit privat, z.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, ka bërë shtjellimin e Raportit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarruesit privat duke theksuar se mbetet pranë Raportit. Përmbarruesi privat z. gjithashtu kanë paraqitur qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e ngritura.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbarruesi privat z. nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni gjen me rëndësi të thekson se në rastin konkret pala kreditore kishte dërguar përmes postës elektronike kërkesën dt 03.06.2020, që të ndërpritet procedura përmbarrimore për shkak se pala kreditore ka bërë marrëveshje me palën debitore. Përmbarruesi privat bazuar në shkresat e lëndës, i kishte kthyer përgjigje të menjëhershme me dt 06.06.2020 palës kreditore duke i kërkuar që t'ia përcjellë marrëveshjen e arritur me debitorin si dhe i kishte ofruar informacionin e duhur për procedurat që duhet ndjekur në mënyrë që të tërhiqet lënda nga Gjykata dhe e njëjta të përfundojë. Komisioni gjen se përmbarruesi privat kishte vepruar konform ligjit duke kërkuar marrëveshjen dhe ofruar informacionet palëve meqenëse marrëveshja ishte arritur mes palëve pa prezencën e përmbarruesit privat dhe pa e njoftuar të njëjtin. Palët bazuar në shkresat e lëndës nuk kishin vepruar sipas udhëzimeve të përmbarruesit privat. Rrjedhimisht, lëshimet në ndjekjen e procedurave ligjore nga palët nuk mund t'i atribuohen përmbarruesit privat. Me dt 31.08.2021, pala kreditore përsëri përmes postës elektronike kishte njoftuar përmbarruesin privat se borxhi ishte përmbushur në tërësi por nuk i kishte përcjellë dëshminë e kryerjes së borxhit lëndor. Po sa përmbarruesi privat ishte njoftuar me dt 01.09.2021 që pala debitore ka kryer pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarrimore, i njëjti ka liruar llogaritë. Përmbarruesi privat ka ndërmarr gjitha veprimet ligjore brenda afateve, iu ka dhënë palëve informatat pa vonesa të paarsyeshme.

Për sa i përket tarifës së efikasitetit, Komisioni vjen në përfundim që pala debitore nuk ka realizuar brenda afateve përmbushjen vullnetare. Si rezultat, pala debitore obligohej për pagesën e shpenzimeve të efikasitetit sipas nenit 367 par 1, nën par 1.1,1.2 dhe 1.7 të LPP dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr 06/14 për Tarifat për Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve të Përmbarruesit Privat. Në fakt, duke njoftuar palën debitore që të përmbush edhe shpenzimet e efikasitetit, përmbarruesi privat është përmbajtur nga krijimi i shpenzime tjera përmes ndërmarrjes së veprimeve përmbarrimore. Në këtë mënyrë, përmbarruesi ka vepruar drejtë për t'u siguruar që përmbarrimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundur për palën debitore. Rrjedhimisht, Komisioni gjen se përmbarruesi privat z. ka vepruar në pajtim me ligjin dhe autorizimet e tij.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 42/2021, datë 17.11.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUPI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.